



Informacione në gjuhë të thjeshtë

Çfarë do të thotë karantinë?

Nëse keni takuar dikë me një sëmundje, ndoshta ai ju ka infektuar.

Zgjat disa ditë deri sa sëmundja të shfaqet.

Por: Ju ndërkohë mund të infektoni të tjerë.

Prandaj zyra e shëndetësisë ju merr në telefon dhe ju thotë: Ju duhet të qëndroni në **karantinë** shtëpie.

Kjo gjë shqiptohet: Ka-ran-ti-në (Ka-ran-tä-ne).

Ju jeni i detyruar të qëndroni **në shtëpi**.

Ju **nuk** lejoheni të shkoni në **punë**.

Ju **nuk** lejoheni të prisni **vizita**.

Nëse banoni bashkë me të tjerë, ju jeni i detyruar të qëndroni në dhomën tuaj.

Ju jeni i detyruar të **ushqeheni i vetëm**.

Karantina zgjat dy javë.

Telefononi miqtë dhe të afërmit. Ato mund t'ju ndihmojnë.

Për shembull që të bëjnë për ju

- blerjet e nevojshme
- të nxjerrin qenin në shëtitje

Nëse nuk mund t'ju ndihmojë **askush**, thojani një gjë të tillë zyrës së shëndetit publik.



Çfarë është Corona-Virus?

Corona-Virus është një shkaktar sëmundjesh.

Corona-Virus quhet edhe COVID-19.

Çfarë ndodh nëse jeni infektuar me Corona-Virus?

Nëse janë infektuar me Corona-Virus njerëzit kanë:

- Rrjedhje hundësh dhe kollë
- Ethe
- Probleme me frymëmarrjen

Për njerëzit e dobët dhe të vjetër sëmundja mund të jetë e rrezikshme.

Disa njerëz vdesin për shkak të sëmundjes.

Një njeri i infektuar me Corona-Virus

mund të infektojë njerëzit e tjerë.

Për shembull:

- Kur njeriu i kollitet në fytyrë njerëzve të tjerë.
- Nëse njeriu teshtin në afërsi të njerëzve të tjerë.



Këto gjëra janë të rëndësishme:

- Lani duart rregullisht.
- Teshtini në këndin e bërrylit.
- Përdorni letër ose façoleta, nëse keni rrjedhje të hundëve



Urdhri i karantinës i dhënë me gojë është po aq i detyrueshëm për tu zbatuar ashtu si edhe njoftimi me shkrim.

Ju duhet të llogarisni me pasoja të ndjekjes penale, nëse nuk respektoni urdhrin e karantinës.